



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 254/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), dega në Istog, për shkak të ofrimit të mitos për fotografimin e fletëvotimeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 11.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK dega në Istog, me të cilën pretendohet se aktivistët e PDK-së kanë vërejtur se në qytetin e Istogut konkretisht në fshatin Vrellë afër vendvotimit, kandidati i AAK-së për deputet Gani Dreshaj bashkë me një grup të mbështetësve të AAK-së ju ka ofruar qytetarëve mito për fotografimin e fletëvotimit, andaj parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AAK ka bërë shkelje e nenit 33 pika f) të Ligjit për Zgjedhjet e Pergjithshme në Kosovë.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi informata më të hollësishme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se lidhur, me rastin në fjalë janë kontaktuar eprorët dhe zyrtarët policor të cilët kanë qenë në zbatim të planit operativ për ditën e zgjedhjeve në Komunën e Istogut, nga të cilët është marrë konfirmimi që nuk kanë qenë të kontaktuar nga qytetarët apo ndonjë votues, apo nga ndonjë subjekt politik, për ndonjë informacion apo ndonjë ankesë lidhur me ndonjë parregullsi në fshatin Vrellë të Komunës së Istogut.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohen pretendimet ankimore. Për më tepër, nga raporti i policisë së Kosovës rezulton se gjatë ndërmarrjes së veprimeve hetimore nga ana e Policisë së Kosovës nuk kanë arritur që të gjejnë apo të identifikojnë ndonjë parregullsi në vendin e pretenduar në ankesë, prandaj PZAP-i vendosi se një pretendim i tillë i ankesës se në qytetin e Istogut konkretisht në fshatin Vrellë afër vendvotimit kandidati i AAK-së për deputet Gani Dreshaj bashkë me një grup të mbështetësve të AAK-së ju ka ofruar qytetarëve mito për fotografimin e fletëvotimit, është i pa argumentuar dhe i pa bazuar në fakte dhe prova, dhe si e tillë ankesa është e pa bazë, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 254/2014 më datën 11.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*